



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLESIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
RAJONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

PRISHTINA




RAPORTI TM3 I KRU “PRISHTINA” Sh.A. PËR VITIN 2024

Vendimi: (1-38)

Bordi i Drejtorëve të KRU “Prishtina” Sh.A., i emëruar me vendimin e Qeverisë nr.01/81, të datës 01.06.2022 dhe i plotësuar me vendimin nr.05/186, të datës 24.01.2024, në mbledhjen e tridhjetë e tetë të rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024, pas shqyrtimit dhe analizimit paraprak të Raportit TM3 të KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2024, unanimisht aprovoi Raportin tremujor TM3 - 2024.

Raporti TM3 i KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2024 do të dorëzohet në NJPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

	Delegoi	Aprovoi
Emri dhe mbiemri:	Zt. Arsim Fetahu Kryeshef Ekzekutiv	Zt. Bashkim Pllana Kryesues i BD-së
Nënshkrimi:		
Datë:	27.11.2024	27.11.2024



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

PRISHTINA

RAPORT TM3 - 2024

KRU "PRISHTINA" Sh.A. – PRISHTINË

PËRMBAJTJA

I.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	3
1.2	Aktivitetet kryesore	3
1.3	Disa nga aktivitetet kryesore:	3
II.	DEPARTAMENTI TEKNIK	4
2.2	Prodhimi	4
2.3	Situata e furnizimit	5
2.4	Detektimi.....	6
2.5	Intervenimet ne rrjet	7
2.6	Shërbimi i ndërrimit të ujëmatësese	9
2.7	Aplikime për kushte teknike.....	10
2.8	Aplikime për kyçje të reja	10
2.9	Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH.....	11
2.10	Problemet e evidentuara	12
2.11	Masat e propozuara	12
2.12	Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së	12
III.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	13
3.2	Numri i konsumatorëve	13
3.3	Faturimi -m3.....	15
3.4	Faturimi - €	17
3.5	Arkëtimi - €.....	19
3.6	Inspektimi dhe Shkqja	22
3.7	Aktivitetet kryesore	24
3.8	Problemet e evidentuara	25
3.9	Masat e propozuara	25
IV.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	26
4.2	Aktivitetet kryesore	26
4.3	Shpenzimet – TM3-2024	26
4.4	Arsyeshmëria e shpenzimeve	28
4.5	Problemet e evidentuara	28
4.6	Masat e propozuara	28
4.7	Transaksionet kryesore.....	28
V.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	29
5.2	Personeli.....	29
5.3	Përmbauesit privat.....	29
VI.	AUDITORI I BRENDSHËM.....	30

VII.	ZYRA E PROKURIMIT	30
VIII.	DEPARTAMENTI I CILËSISË DHE BURIMEVE TE UJIT	34
8.2	Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues	34
8.3	Specifiko disa nga aktivitetet kryesore	35
8.4	Punët e planifikuara në shërbime përkatëse dhe shkalla e realizimit të tyre.....	35
8.5	Shërbimi kualiteti i ujit pijshëm	35
IX.	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	38
9.2	Aktivitete te rregullta sipas detyrave te punës:	39
9.3	Aktivitete te veçanta administrative gjate periudhës se raportimit:	39
9.4	Aktivitete te veçanta teknike gjate periudhës se raportimit:	39
9.5	Veprimet për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA.....	40
X.	PERFORMANCAT E PËRGJITHSHME	42
10.2	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM3/2024-TM3/2024.....	42
XI.	PASQYRAT FINANCIARE	43
11.2	Bilanci i Gjendjes	43
11.3	Pasqyra e të ardhurave	44
11.4	Cash Flow.....	45
XII.	REALIZIMI I CAQEVE -KRU „PRISHTINA“ SH.A	46
XIII.	ORGANOGRAMI	47

I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

1.2 Aktivitetet kryesore

- ✓ Takim me drejtuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për projektet e shtrirjes së rrjetit në Komunën e Fushë Kosovës.
- ✓ Takim me Kryetarin e Komunës së Podujevës dhe Shtimes për koordinim të projekteve të përbashkëta dhe furnizimin stabil me ujë.
- ✓ Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Komunën e Graçanicës për projekte në infrastrukturën e furnizimit me ujë (shtrimi i rrjetit dhe ndërtimi i rezervuarit).
- ✓ Takim me Nënkryetarin e Komunës së Drenasit për koordinim të projekteve të përbashkëta dhe furnizimin stabil me ujë në Drenas dhe fshatrat e Komunës së Drenasit.
- ✓ Punëtori me konsulentin e masave shoqëruese “JV Gopa Infra GmbH/Emscher Wassertechnik GmbH” ku u diskutuan dhe prezantuan pikat kyçe dhe objektivat. Kompania konsulente ofroi një pasqyrë të objektivave, prezantoi ekspertët kryesorë dhe theksoi qëllimet kryesore të kontratës si, zvogëlimi i ujit të pa-faturuar si dhe mbështetja për Njësinë Implementuese të Projektit për projektin:
- ✓ Punëtori me Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e lartë , për Planin e Biznesit 2025-2027
- ✓ Takim me kontingjentin e KFOR-it Britanik, dhe vizitën në impiantin e trajtimit të ujit të pijes në Shkabaj.
- ✓ Aktivitete me takimet e ISHKP, ARRU dhe Këshillin Ndërmënsor për siguri të ujit, për çështjen e manganit në liqenin e Badovcit.
- ✓ Vizita në teren për të mbikëqyrur ecurinë e punëve me fondet e ME dhe fondeve të KRU Prishtina.
- ✓ Vendorsja e gur themelit të rezervuarit për ujë të pijes në Bardh, Lismir, Grabovc dhe Mes Bardh se bashku me Valon Prebrezën Drejtor i NJMNP-së.
- ✓ Takim me KfW, AFD, KE, PIU dhe Kabineti, diskutimi i masave të Projektit, Progresit të Projektit dhe koordinimi mes palëve të interesit
- ✓ Takimi me anëtarët e SHUKOS në zyrtarët e KRU Prishtinës,
- ✓ Njoftime për gjendjen e nivelit të ujit dhe manganit në liqenin e Badovcit,
- ✓ Njoftime për furnizim me ujë të pijes përmes Autoboti-t,
- ✓ Aplikimi i shkyçjeve nga sistemi publik i ujësjellësit për objektet banesore të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet teknike,

1.3 Disa nga aktivitetet kryesore:

- ✓ Monitorimin në cilësinë të ujit të pijshëm 24 h pa ndërprerë,
- ✓ Njoftime për nivelin e ujit në liqenet akumuluese sipërfaqësore Batllava dhe Badovci,
- ✓ Njoftime të rëndësishme për punime teknike në rrjetin e ujësjellësit,
- ✓ Njoftime për kërkesë të konsumatorëve për pagesa të shërbimeve për ujë e kanalizim,
- ✓ Njoftime të rëndësishme, ku palë të treta dëmtuan gypat e ujit,
- ✓ Njoftime për shpenzim racional të ujit të pijshëm dhe mbrojtja e burimeve të ujit,

II. DEPARTAMENTI TEKNIK

2.2 Prodhimi

Tabela nr.1 – Prodhimi m3– Korrik-Shtator-2024

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2024
1	PRISHTINË	3,395,563	3,445,964	3,178,982	10,020,509
2	GRACANICË	461,590	435,407	438,794	1,335,791
3	FUSHË KOSOVË	268,647	255,463	257,512	781,622
4	PODUJEVË	181,881	172,951	174,690	529,522
5	OBILIQ	150,270	138,490	129,030	417,790
6	LIPJAN	230,825	266,508	240,251	737,584
7	SHTIME	350,320	351,962	332,722	1,035,004
8	DRENAS	271,121	294,214	285,279	850,614
9	Gjithsej- KRUP	5,310,218	5,360,959	5,037,260	15,708,437

Koment: Gjatë kësaj periudhe raportuese, është vërejtur një rritje e ndjeshme në sasinë e ujit të trajtuar, e cila tregon një kërkesë të lartë për ujë. Ky fenomen lidhet edhe me temperaturat e larta të regjistruara gjatë kësaj kohe në veçanti në muajin korrik dhe gusht, të cilat kanë shtuar nevojën për furnizim me ujë.

Tabela nr. 2 – Prodhimi m3–TM3-2023/2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3-2024	Dallimi	Dallimi në %
1	PRISHTINË	9.210.265	10.020.509	810.244	8,80%
2	GRACANICË	594.515	1.335.791	741.276	124,69%
3	FUSHË KOSOVË	1.698.610	781.662	-916.948	-53,98%
4	PODUJEVË	1.209.283	529.522	-679.761	-56,21%
5	OBILIQ	916.899	417.790	-499.109	-54,43%
6	LIPJAN	780.156	737.584	-42.572	-5,46%
7	SHTIME	411.911	1.035.004	623.093	151,27%
8	DRENAS	801.902	850.614	48.712	6,07%
9	Gjithsej- KRUP	15.623.542	15.708.476	84.934	0,54%

Diagrami nr. 2. – Prodhimi –TM3-2023/2024





Tabela nr.3 – Realizimi i caqeve- Prodhimi m3 TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi në %
1	PRISHTINË	10.020.509	9.995.119	25.390	0,25%	100,25%
2	GRAÇANICË	1.335.791	513.583	822.208	160,09%	260,09%
3	FUSHË KOSOVË	781.622	1.264.205	-482.583	-38,17%	61,83%
4	PODUJEVË	529.522	869.141	-339.619	-39,08%	60,92%
5	OBILIQ	417.790	711.115	-293.325	-41,25%	58,75%
6	LIPJAN	737.584	790.128	-52.544	-6,65%	93,35%
7	SHTIME	1.035.004	513.583	521.421	101,53%	201,53%
8	DRENAS	850.614	829.634	20.980	2,53%	102,53%
9	Gjithsej- KRUP	15.708.437	15.486.509	221.928	1,43%	101,43%

Diagrami nr. 3. – Realizimi i caqeve- Prodhimi TM3-2024



2.3 Situata e furnizimit

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, furnizimi me ujë ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm dhe pa vështirësi të theksuara. Në disa raste, sidomos në zonat e larta, është vërejtur mungesë e ujit të pijshëm për shkak të konsumit të lartë në zonat më të ulëta, veçanërisht gjatë periudhave me kërkesë të lartë gjatë kohës së pikut të verës. Kjo situatë është ndikuar nga kërkesa e lartë për ujë, e cila reflektohet në sasinë e rritur të ujit të trajtuar. Megjithatë, situata e burimeve ujore ka qenë e favorshme, me nivele të larta të ujit të akumuluar në të dy liqenet, duke mundësuar trajtimin e sasisë së mjaftueshme të ujit për të gjithë zonën e shërbimit.

Në përgjithësi, tremujori TM3 2024 ka kaluar pa sfida të mëdha në trajtimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm për zonën e shërbimit. Pavarësisht kësaj, problem mbetet niveli i turbullirës në kanal dhe pamundësia e trajtimit të ujit në ITUP Shkabaj gjatë reshjeve, çka tregon nevojën për përmirësime të mëtejshme në infrastrukturën e trajtimit të ujit.

Furnizimi me ujë ka vijuar pa probleme shtesë gjatë periudhës së vazhdueshme, por me rritjen e temperaturave janë shfaqur sfida. Kapacitetet eksploatuese të prodhimit të ujit të pijshëm në pusët e komunës së Lipjanit janë ulur me 10-20%, gjë që ka çuar në aplikimin e reduktimeve të furnizimit në lagjet periferike dhe në disa fshatra të qytetit të Lipjanit.

2.4 Detektimi

Tabela nr.4 Ekipa e detektimit – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuar	Nr. i defekteve te identifikuar
1	PRISHTINË	151	125	169	182
2	GRACANICË	10	2	1	8
3	FUSHË KOSOVË	20	2	2	9
4	PODUJEVË	19	2	2	5
5	OBILIQ	1	0	0	0
6	LIPJAN	11	0	2	0
7	SHTIME	6	0	0	0
8	DRENAS	8	0	0	0
9	Gjithsej- KRUP	226	131	177	204

Koment: NJOU nuk kanë staf te veçante për detektim, por detektimet në NJOU bëhen me kërkesën e tyre drejtuar stafit në qendër, dhe detektimi behet nga stafi i qendrës.

Tabela Nr.5 Ekipi i detektimit – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuar (km)	Nr. i defekteve te identifikuar
1	Korrik	58	70	70	55
2	Gusht	91	58	56	91
3	Shtator	77	3	50	58
4	Gjithsej- KRUP	226	131	169	204

Diagrami nr. 5. – Ekipi i detektimit – TM3-2024





Tabela nr.6 Ekipi i detektimit –TM3-2023/2024

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuar (km)	Nr. i defekteve te identifikuar
1	TM3-2023	138	32	32	132
2	TM3-2024	226	131	176	204
3	Dallimi	88	99	144	72
4	Dallimi-%	63,77%	309,38%	450,00%	54,55%

Diagrami nr.6. – Ekipi i detektimit –/TM3-2023/2024



2.5 Intervenimet ne rrjet

Tabela nr.7 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	PRISHTINE	474	450	13	937
2	GRACANICË	64	122	0	186
3	FUSHE KOSOVE	62	74	24	160
4	PODUJEVE	144	46	0	190
5	OBILIQ	16	33	0	49
6	LIPJAN	98	150	0	248
7	SHTIME	213	68	0	281
8	DRENAS	99	50	0	149
9	Gjithsej- KRUP	1,170	993	37	2,200

Koment: Intervenimet janë bërë në të gjitha rastet e lajmëruara, me ekipet që posedon departamenti.

Tabela nr.8 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2023/2024

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	TM3-2023	1.038	1.248	45	2.331
2	TM3-2024	1.170	993	37	2.200
3	Dallimi	132	-255	-8	-131
4	Dallimi në %	12,72%	-20,43%	-17,78%	-5,62%

Diagrami nr.8. – Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2023/2024




Tabela nr.9 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2024

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	Korrik	353	420	8	781
2	Gusht	402	198	13	613
3	Shtator	415	375	16	806
4	Gjithsej	1,170	993	37	2,200

Tabela nr.10 Pastrimi i pushtave te kanalizimit – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Pastrimi i pushtave	Pastrimi i pushtave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pushtave	Rehabilitimi i rrjetit
1	PRISHTINË	100	2,732	9	1
2	GRACANICË	0	488	0	0
3	FUSHË KOSOVË	0	298	0	0
4	PODUJEVË	0	184	0	0
5	OBILIQ	7	16	0	0
6	LIPJAN	24	32	0	0
7	SHTIME	46	18	0	0
8	DRENAS	8	76	0	0
9	Gjithsej- KRUP	185	3,844	9	1

Tabela nr.11 Pastrimi i pushtave te kanalizimit – TM3-2024


Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pushtave	Pastrimi i pushtave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pushtave	Rehabilitimi i rrjetit
1	Korrik	49	1,322	4	0
2	Gusht	57	1,412	4	0
3	Shtator	79	1,110	1	1
4	Gjithsej	185	3,844	9	1

Tabela nr.12 Pastrimi i pusetave te kanalizimit – TM3-2023/2024

Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pusetave	Pastrimi i pusetave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pusetave	Rehabilitimi i rrjetit
1	TM3-2023	282	3.424	4	7
2	TM3-2024	185	3.844	9	1
3	Dallimi	-97	420	5	-6
4	Dallimi në %	-34,4%	12,3%	125,0%	-85,7%

Koment: Sipas krahasimit të periudhave të njëjta TM3 për vitet 2023/2024, në përgjithësi ka pas aktivitete dhe progres të shtuar, megjithatë rehabilitimi i rrjetit ka rënie të theksuar gjatë kësaj periudhe.

Diagrami nr.12 - Pastrimi i pusetave te kanalizimit – TM3-2023/2024



2.6 Shërbimi i ndërrimit të ujëmatësve


Tabela nr.13 Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Shtëpiak	Komercial	Institucional	Gjithsej
1	PRISHTINË	247	96	0	343
2	GRACANICË	65	7	0	72
3	FUSHË KOSOVË	61	1	0	62
4	PODUJEVË	10	0	2	12
5	OBILIQ	61	6	0	67
6	LIPJAN	158	8	2	168
7	SHTIME	78	0	0	78
8	DRENAS	63	0	0	63
9	Gjithsej- KRUP	743	118	4	865

Tabela nr.14 Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2023/2024

Nr.	Përshkrimi	Shtëpiak	Komercial	Institucional	Gjithsej
1	TM3-2023	433	88	9	530
2	TM3-2024	743	118	4	865
3	Dallimi	310	30	-5	335
4	Dallimi -%	71.6%	34.1%	-55.6%	63.2%

Diagrami nr.14 - Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2023/2024



2.7 Aplikime për kushte teknike

Tabela nr.15 Periudha raportuese:TM3 2024

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINË	54	54	0
2	GRACANICË	10	10	0
3	FUSHË KOSOVË	3	3	0
4	PODUJEVË	22	22	0
5	OBILIQ	7	7	0
6	LIPJAN	22	22	0
7	SHTIME	20	20	0
8	DRENAS	11	11	0
9	Gjithsej- KRUP	149	149	0

2.8 Aplikime për kyçje të reja

Tabela nr.16 Periudha raportuese:TM3 2024

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINË	30	18	8
2	GRACANICË	8	0	4
3	FUSHË KOSOVË	2	1	0
4	PODUJEVË	2	0	0
5	OBILIQ	0	0	0
6	LIPJAN	0	0	0
7	SHTIME	3	1	0
8	DRENAS	10	0	0
9	Gjithsej- KRUP	55	20	12

2.9 Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH

Tabela nr.17 Periudha raportuese:TM3 2024

Hartimi i Projekteve për Zbatim të planifikuara në periudhën raportuese të TM3 nga DPZH

Nr.	Investimet Kapitale/DPZH/Emërtimi i Projektit	Statuti /Projekti	Projekti në proces
1	Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm për fshatrat Bardh i Madh, Grabovc dhe Mes Bardhi të komunës së Fushë-Kosovës, me një vlerë financiare prej 300,000.00 euro. Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024. Aneksi: Gyp maxhistrat për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat e Fushë-Kosovës, me një vlerë financiare prej 170,000.00 euro. Marrëveshje për financim e projekteve kapitale ndërmjet: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	40% e punimeve janë përfunduar
2	Projektit të rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Orllan, Turiçicë dhe Kalatice të Komunës së Podujevës: Vlera financiare 170,000.00 euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024	Në proces	Projekti është në procedure të prokurimit
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatin Herticë-komuna e Podujevës në vlerë financiare: 400,000.00 euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	10% e punimeve janë përfunduar
4	Rehabilitimi i rrjetit të Kanalizimit në fshatrat e komunës së Shtimes Faza:2 Vlera financiare 294,200.00 euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	30% e punimeve janë përfunduar
5	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyqjet individuale në rrjetin e fshatit Kishnicë të komunës së Graçanicës: Vlera financiare 95,000.00euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	28% e punimeve janë përfunduar
6	Hapja e puseve për furnizim me ujë të pijshëm dhe ndërtim i sistemit të pompimit Komuna Shtime Vlera financiare 300,000.00euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	i përfunduar	15% e punimeve janë përfunduar
7	Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR “Prishtina” Vlera financiare 275,000.00euro me mjete vetanake 2. Rehabilitim i 11jësjelesit Lipjan dhe Graçanicë Llot 1 e kontraktuar 147,227.95€ 2. Rehabilitim i 11jësjelesit Drenas dhe Obiliq Llot 2 e kontraktuar 88,415.80€	Në zbatim	Lot 1: 35% e punimeve janë përfunduar, Lot 2: 44% e punimeve janë përfunduar,
8	Projekte të ndryshme të bashkëfinancimit me komunat, komunitetin, donatorët. Fokusimi në zgjerimin e rrjetit, zëvendësimi i rrjetave të amortizuara dhe mirëmbajtje dhe operim të njëjtave (rrjeti i ujit dhe ujërave të ndotura) Vlera financiare 250,000.00euro me bashkëfinancim me Komuna	Në proces	Ne proces të tenderimit
9	Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28,29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe Vlera financiare 2,769,873.91 euro	Në zbatim	80% e punimeve janë përfunduar

	Projekti kapital në Fushë Kosovë i financuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Pushtetit dhe Administrimit Lokal 2024-2025		
--	---	--	--

Nr.	Investimet e projekteve me donator	Statuti /Projekti	Projekti në proces
1	Trajtimi i Ujërave të Zeza për Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë – Komponenti i Ndërtimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza Kontrata per Konsulencën për Implementim: Vlera e kontratës: 3,453,838.80 Euro Sipas marrëveshjeve me MF dhe Thesarit Francez -Kredi	Në proces	Raporti fillestar dhe studimi i fizibilitetit kanë përfunduar.
2	Trajtimi i ujërave të zeza për Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë – Komponenti i Kolektorit/Rrjetit të Kanalizimit, AMC -Kontrata për Konsulencën për Masat Shoqëruese: Vlera e kontratës: 2,991,390.25 Euro -Kontrata për Konsulencën për Implementim: Vlera e kontratës: 3,741,431.75 Euro Nënshkrimi i Marrëveshjeve MF/ME, KRUP dhe KfW-Grand	Në proces	-Masat shoqëruese dhe suport për PIU. Raportet fillestare janë dorëzuar. -Raporti fillestar ka përfunduar. Draft dizajni për kolektorët është dorëzuar dhe kontrolluar/komentuar nga KRUP.

2.10 Problemet e evidentuara

Vjetërsia e rrjetit të shpërndarjes dhe rrjetit të ujërave të ndotura, bënë që të ketë ndërhyrje të shpeshta në sistemet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Tubacionet e rrjetit primar, sekondar dhe terciar kryesisht janë nga materiali AC, FeZn, PVC, që janë ndërtuar ndërmjet viteve të '60; '70; '80; Këto material janë zakonisht me diametër të ndryshëm që shkon nga DN15mm-DN250mm dhe te cilat kane shkalle të larte të dëmtimit te cilat rrisin çdo ditë humbjet fizike. Për këtë infrastrukturën e lartcekur jetëgjatësia e asetit tani është zero por te cilat edhe tani janë në funksion.

2.11 Masat e propozuara

Ndërrimi i infrastrukturës së vjetër me të re, një gjatësi është planifikuar për rehabilitim te rrjetit të ujësjellësit edhe këtë vite në tërë zonën e shërbimit është duke jap prioritet tubacionet me më shumë rrjedhje.

2.12 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së

Në kuadër të përpjekjeve për zvogëlimin e humbjeve të ujit, janë marr hapat konkretë për zvogëlimin e UPF-së. Aktivitetet e planifikuara përfshijnë kontrollin dhe analizën e gjendjes së ujëmatësve, instalimin e ujëmatësve të rinj, monitorimin e DMA-ve, dhe identifikimin e humbjeve teknike dhe komerciale. Gjithashtu, është planifikuar krijimi i zonave të reja DMA dhe modelimi hidraulik i rrjetit për menaxhimin e presioneve.

Aktivitetet e realizuara janë si më poshtë:

- Është inspektuar dhe kontrolluar gjendja e ujëmatësve në të gjitha pikat e prodhimit dhe është analizuar gjendja e tyre funksionale.
- Është inspektuar dhe kontrolluar gjendja e ujëmatësve në SP dhe në rezervuar, ku ky aktivitet është realizuar deri tani në 80%.

- Është analizuar gjendja e ujëmatësve jofunksionalë zonalë dhe janë vlerësuar 88 puseta ekzistuese së bashku me ujëmatësit.

Pas inspektimit dhe vlerësimit, po përgatitet paramasa dhe parallogaria për rinovimin, demelimin ose ndërtimin e puseve të reja që do të jenë funksionale dhe të përshtatshme për instalimin e ujëmatësve dhe datallogerëve për lexim nga distanca.

III. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.2 Numri i konsumatorëve


Tabela nr.18 Numri i konsumatorëve – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2024
1	Prishtinë	101,833	102,347	102,710	102,710
2	Fushë Kosovë	29,002	29,231	29,283	29,283
3	Obiliq	6,373	6,372	6,405	6,405
4	Graçanicë	3,947	3,951	3,964	3,964
5	Shtime	3,999	4,033	4,048	4,048
6	Lipjan	13,095	13,108	13,112	13,112
7	Podujevë	12,842	12,965	13,044	13,044
8	Drenas	6,526	6,553	6,599	6,599
9	Gjithsej- KRUP	177,617	178,560	179,165	179,165

Tabela nr.19 Nr. i konsumatorëve – TM3 2023/2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3-2024	Nryshimi	Nryshimi- %
1	Prishtinë	98,887	102,710	3,823	3.87%
2	Fushë Kosovë	27,775	29,283	1,508	5.43%
3	Obiliq	6,239	6,405	166	2.66%
4	Graçanicë	3,872	3,964	92	2.38%
5	Shtime	3,832	4,048	216	5.64%
6	Lipjan	12,545	13,112	567	4.52%
7	Podujevë	12,519	13,044	525	4.19%
8	Drenas	6,417	6,599	182	2.84%
9	Gjithsej- KRUP	172,086	179,165	7,079	4.11%

Diagrami nr.17 - Nr. i konsumatorëve – TM3 2023/2024




Koment: Numri i konsumatorëve për periudhën e njëjtë TM3 2024 në raport me periudhën TM3 2023, ka pasur trend të rritjes prej 4.11% në total

Tabela nr.20 Realizimi i caqeve- Numri i konsumatorëve – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi në %
1	Prishtinë	102,710	104,571	-1,861	-1.78%	98.22%
2	Fushë Kosovë	29,283	31,102	-1,819	-5.85%	94.15%
3	Obiliq	6,405	6,159	246	3.99%	103.99%
4	Graçanicë	3,964	4,044	-80	-1.98%	98.02%
5	Shtime	4,048	4,029	19	0.47%	100.47%
6	Lipjan	13,112	13,236	-124	-0.94%	99.06%
7	Podujevë	13,044	12,626	418	3.31%	103.31%
8	Drenas	6,599	6,694	-95	-1.42%	98.58%
9	Gjithësej-KRUP	179,165	182,461	-3,296	-1.81%	98.19%

Komenti: Përformanca e përgjithshme për periudhën TM3-2024 ka qenë e kënaqshme, duke arritur realizimin e 98.19% të objektivave të planifikuara për numrin e konsumatorëve.

Diagrami nr.18 Realizimi i caqeve- Numri i konsumatorëve – TM3-2024



3.3 Faturimi -m3

Tabela nr.21 Faturimi m3 – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2024
1	Prishtinë	1,379,055	1,396,288	1,478,281.44	4,253,624
2	Fushë Kosovë	238,192	245,473	238,439.53	722,105
3	Obiliq	116,987	109,962	126,196.00	353,145
4	Graçanicë	60,620	50,072	64,780.96	175,473
5	Shtime	58,217	50,312	55,633.00	164,162
6	Lipjan	115,344	123,979	118,778.71	358,102
7	Podujevë	183,063	176,976	162,154.00	522,193
8	Drenas	90,462	124,040	138,838.22	353,340
9	Gjithsej- KRUP	2,241,940	2,277,102	2,383,102	6,902,144

Tabela Nr.22 Faturimi m3 – TM3-2023/2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3-2024	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	4,219,924	4,253,624	33,700	0.80%
2	Fushë Kosovë	682,019	722,105	40,086	5.88%
3	Obiliq	356,058	353,145	-2,913	-0.82%
4	Graçanicë	175,939	175,473	-466	-0.26%
5	Shtime	134,423	164,162	29,739	22.12%
6	Lipjan	321,554	358,102	36,548	11.37%
7	Podujevë	476,029	522,193	46,164	9.70%
8	Drenas	209,100	353,340	144,240	68.98%
9	Gjithsej- KRUP	6,575,046	6,902,144	327,098	4.97%

Diagrami nr. 19. – TM3 2023/2024




Koment: Të dhënat tabelare tregojnë një rritje prej 4.97% në faturimin total të ujit në metra kub për periudhën TM3 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Njësitë operative si Drenasi 68.98% , Podujeva 9.70%, Lipjani 11.37% dhe Shtimja 22.12%, kanë shënuar rritje të dukshme duke ndikuar në përmirësimin e përgjithshëm të performancës së faturimit. (Drenasi me performancën më të mirë është si rezultat i operimit në teren me dy lexues të ri).

Megjithatë, sfidat e leximit të rregullt mbeten një pengesë e rëndësishme. Konsumatorët që mungojnë në pronat e tyre gjatë orarit të punës, si dhe ata që jetojnë jashtë vendit, e vështirësojnë procesin e leximit. Gjithashtu, terrenet e palexuara të trashëguara ndër vite, për shkak të mungesës së stafit mbulues për lexime apo leximit të parregullt, kanë kontribuar në devijime të konsiderueshme në të dhënat e raportuara midis viteve 2023 dhe 2024.

Tabela Nr.23 Realizimi i caqeve -Faturimi m3 – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	4,253,624	4,401,615	-147,991	-3.36%	96.64%
2	Fushë Kosovë	722,105	737,897	-15,792	-2.14%	97.86%
3	Obiliq	353,145	387,383	-34,238	-8.84%	91.16%
4	Graçanicë	175,473	208,645	-33,172	-15.90%	84.10%
5	Shtime	164,162	197,543	-33,381	-16.90%	83.10%
6	Lipjan	358,102	366,972	-8,870	-2.42%	97.58%
7	Podujevë	522,193	496,791	25,402	5.11%	105.11%
8	Drenas	353,340	330,642	22,698	6.86%	106.86%
9	Gjithsej- KRUP	6,902,144	7,127,488	-225,344	-3.16%	96.84%

Diagrami nr. 20. - Realizimi i caqeve m3



Koment: Për periudhën TM3 të vitit 2024, realizimi i faturimit të ujit në metra kub arriti në 96.84% të objektivave të përcaktuara në planin e biznesit. Shumica e njësive operative tregojnë përmbushje të mirë të planifikimeve, me përjashtim të Podujevës dhe Drenasit, të cilat kanë tejkaluar objektivat e tyre, me një realizim përkatësisht prej 105.11% dhe 106.86%, duke treguar përmirësim të ndjeshëm të performancës.

Në anën tjetër, disa njësi si Graçanica dhe Shtime kanë pasur një diferencë më të madhe nga objektivat por pavarësisht këtyre dallimeve, Përformanca totale tregon një përputhje të afërt me synimet e planit të biznesit për TM3-2024.

3.4 Faturimi - €

Tabela nr.24 Faturimi € – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2024
1	Prishtinë	900.358	913.279	960.328	2.773.965
2	Fushë Kosovë	159.371	164.791	160.125	484.287
3	Obiliq	75.588	71.276	83.528	230.392
4	Graçanicë	38.030	34.645	39.658	112.333
5	Shtime	35.611	31.154	32.154	98.919
6	Lipjan	78.281	82.078	66.928	227.287
7	Podujevë	109.510	107.804	100.942	318.256
8	Drenas	53.968	68.563	79.507	202.038
9	Gjithsej- KRUP	1.450.717	1.473.590	1.523.170	4.447.477

Tabela nr.25 Faturimi €, Realizimi i caqeve – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi TM3 2024	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,773,965	2,861,308	-87,343	-3.05%	96.95%
2	Fushë Kosovë	484,287	496,410	-12,123	-2.44%	97.56%
3	Obiliq	230,391	247,778	-17,387	-7.02%	92.98%
4	Graçanicë	112,333	131,589	-19,256	-14.63%	85.37%
5	Shtime	98,919	128,011	-29,092	-22.73%	77.27%
6	Lipjan	227,288	260,471	-33,183	-12.74%	87.26%
7	Podujevë	318,255	300,868	17,387	5.78%	105.78%
8	Drenas	202,038	198,422	3,616	1.82%	101.82%
9	Gjithsej- KRUP	4,447,476	4,624,857	-177,381	-3.84%	96.16%

Koment: Analiza e faturimit në vlerë monetare për periudhën TM3-2024 tregon një realizim të përgjithshëm prej 96.16% të objektivave të përcaktuara në planin e biznesit. Performanca e përgjithshme në faturim paraqet një trend pozitiv në krahasim me periudhën e mëparshme TM2, me rezultate më të mëdha në njësitë operative të Podujevës dhe Drenasit, të cilat arritën përkatësisht 105.78% dhe 101.82% të planifikimeve të tyre, duke tejkaluar objektivat për këtë periudhë. Në të kundërt, disa njësi si Shtime, Graçanica dhe Lipjani kanë realizuar përqindje më të ulëta ndaj caqeve. Përgjithësisht, kjo periudhë karakterizohet me përmirësime të vazhdueshme dhe angazhime për të përbushur caqet e përcaktuara, të cilat janë të pasqyruara edhe në diagramin për secilën njësi operative.

Diagrami nr. 21. - Realizimi i caqeve m3





Tabela nr.27 Faturimi në € -Realizimi i caqeve pas zbritjes në faturim nga përmirësimet dhe largimet e borxheve për periudhën TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,683,713	2,861,308	-177,595	-6.21%	93.79%
2	Fushë Kosovë	460,525	496,410	-35,885	-7.23%	92.77%
3	Obiliq	228,542	247,778	-19,236	-7.76%	92.24%
4	Graçanicë	106,379	131,589	-25,210	-19.16%	80.84%
5	Shtime	95,883	128,011	-32,128	-25.10%	74.90%
6	Lipjan	225,517	260,471	-34,954	-13.42%	86.58%
7	Podujevë	316,432	300,868	15,564	5.17%	105.17%
8	Drenas	200,788	198,422	2,366	1.19%	101.19%
9	Gjithsej- KRUP	4,317,779	4,624,857	-307,078	-6.64%	93.36%

Diagrami nr. 23. - Realizimi i caqeve për faturim € pas përmasimeve TM3-2024




Koment: Diagrami dhe tabela paraqesin realizimin e faturimit në TM3-2024 pas zbritjes së borxheve. Nga realizimi fillestar prej 96.16%, ky tregues bie në 93.36% për shkak të gabimeve në faturim dhe vendimeve nga komisioni i shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve në KRUP dhe ARRU.

Tabela nr.28 Faturimi € pas zbritjes në faturim nga përmirësimet dhe largimet e borxheve , krahasimi TM3-2023/2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3-2024	Dallimi	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,734,058	2,683,713	-50,345	-1.84%
2	Fushë Kosovë	455,570	460,525	4,955	1.09%
3	Obiliq	223,148	228,542	5,394	2.42%
4	Graçanicë	85,268	106,379	21,111	24.76%
5	Shtime	80,380	95,883	15,503	19.29%
6	Lipjan	213,505	225,517	12,012	5.63%
7	Podujevë	286,879	316,432	29,553	10.30%
8	Drenas	130,156	200,788	70,632	54.27%
9	Gjithsej- KRUP	4,208,964	4,317,779	108,815	2.59%

Diagrami 24-Faturimi € pas zbritjes në faturim nga përmirësimet dhe largimet e borxheve , krahasimi TM3-2023/2024



Koment: Nga të dhënat e faturimit në euro (€) pas zbritjes në faturim nga përmirësimet dhe largimet e borxheve, duke krahasuar të dhënat e TM2-2023/2024 për të gjitha NJOU-të rezulton se shumica e njësive kanë përmirësuar performancën e tyre në faturim krahasuar me vitin e kaluar, veçanërisht Drenasi me një rritje të jashtëzakonshme.

3.5 Arkëtimi - €

Tabela Nr.29 Arkëtimi € – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2024
1	Prishtinë	957.571	1.035.405	1.005.724	2.998.700
2	Fushë Kosovë	161.103	214.880	203.041	579.024
3	Obiliq	57.658	81.814	80.727	220.199
4	Graçanicë	49.933	37.747	50.712	138.392
5	Shtime	32.617	39.197	41.407	113.221
6	Lipjan	72.797	100.208	80.566	253.571
7	Podujevë	110.779	138.714	99.593	349.086
8	Drenas	51.463	71.679	54.874	178.016
9	Gjithsej- KRUP	1.493.921	1.719.644	1.616.644	4.830.209

Tabela Nr.30 Arkëtimi € – TM3-2023/2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3-2024	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	2,961,543	2,998,700	37,157	1.25%
2	Fushë Kosovë	532,261	579,024	46,763	8.79%
3	Obiliq	236,064	220,199	-15,865	-6.72%
4	Graçanicë	114,166	138,392	24,226	21.22%
5	Shtime	88,154	113,221	25,067	28.44%
6	Lipjan	254,383	253,571	-812	-0.32%
7	Podujevë	277,309	349,086	71,777	25.88%
8	Drenas	146,514	178,016	31,502	21.50%
9	Gjithsej- KRUP	4,610,394	4,830,207	219,813	4.77%

Diagrame nr. 25. – TM3 2023 – TM3 2024




Koment: Dallimi në arkëtim midis periudhave TM3-2023 dhe TM3-2024 tregon një rritje prej 4.77%. Rritjet janë evidentuar në pothuajse të gjitha njësitë, përveç rënieve në Obiliq (-6.72%) dhe Lipjan (-0.32%).

Tabela nr.31 Realizimi i caqeve – Arkëtimi € – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,998,700	2,808,874	189,826	6.76%	106.76%
2	Fushë Kosovë	579,024	485,843	93,181	19.18%	119.18%
3	Obiliq	220,199	242,784	-22,585	-9.30%	90.70%
4	Graçanicë	138,392	128,893	9,499	7.37%	107.37%
5	Shtime	113,221	125,619	-12,398	-9.87%	90.13%
6	Lipjan	253,571	255,593	-2,022	-0.79%	99.21%
7	Podujevë	349,086	294,484	54,602	18.54%	118.54%
8	Drenas	178,016	194,326	-16,310	-8.39%	91.61%
9	Gjithsej-KRUP	4,830,209	4,536,416	293,793	6.48%	106.48%

Diagrame nr. 26.- Realizimi i caqeve -Arkëtimi-TM3-2024



Koment: Arkëtimi në euro për njësitë operative gjatë periudhës TM3-2024 tregon një performancë shumë të mirë duke krahasuar me planin e biznesit. Realizimi ka arritur 106.48% për të gjithë KRUP-in, me rritje të dukshme në Podujevë 118.54%, Fushë Kosovë 119.18%, Graçanicë 107.37% dhe Prishtinë 106.76%.

1.6 Ankesat/Kërkesat teknike dhe komerciale

Tabela nr.32 Ankesat /kërkesat teknike dhe komerciale të shqyrtuara nga komisioni TM3-2024

NR	Njësia Operative	Ankesat teknike	Ankesat T.-Të shqyrtuara me kohë	Ankesat komerciale	Ankesat K.-Të shqyrtuara me kohë	Kërkesë Teknike	Kërkesë teknike të shqyrtuara me kohë	Kërkesë komerciale	Kërkesë komerciale të shqyrtuara me kohë
1	Prishtinë	1	0	214	17	188	68	2,372	1,344
2	F. Kosovë	0	0	60	0	17	9	382	250
3	Obiliq	2	0	11	1	3	1	110	61
4	Graçanicë	2	0	3	0	7	6	100	49
5	Shtime	0	0	31	0	6	5	65	46
6	Lipjan	0	0	37	1	42	15	261	154
7	Podujevë	0	0	14	1	23	19	424	247
8	Drenas	0	0	8	0	13	9	186	170
9	Gjithsej-KRUP	5	0	378	20	299	132	3,900	2321

Koment: Në krahasim me llojin e pranimit të kërkesave dhe ankesave në të gjitha NJOU-të, numri më i madh i pranimit të lëndëve janë **ankesa 378** dhe **kërkesa komerciale 3,900**, ndërsa numri më i ulët janë lëndët e ankesave dhe kërkesave teknike. Për sa i përket shqyrtimit me kohë të ankesave dhe kërkesave, tabela pasqyron të dhënat e raportuara mujore. Megjithatë, vetëm në këtë kolonë edhe pse lënda është shqyrtuar me kohë, rastet mbesin të hapura për shkak të procedurave deri në përfundimin e lëndës në program.

Tabela nr.33 Ankesat /kërkesat teknike dhe komerciale të shqyrtuara nga komisioni TM3-2023/2024

NR	Njësia Operative	Ankesat teknike	Ankesat T.-Të shqyrtuara me kohë	Ankesat komerciale	Ankesat K.-Të shqyrtuara me kohë	Kërkesë Teknike	Kërkesë teknike të shqyrtuara me kohë	Kërkesë komerciale	Kërkesë komerciale të shqyrtuara me kohë
1	TM3 2023	3	1	562	10	222	36	3,631	2,080
2	TM3 2024	5	0	378	20	299	132	3,900	2,321
3	Diferenca 2024/2023	2	-1	-184	10	77	96	269	241
4	Difer-%	66.7%	-100%	-32.7%	100.0%	34.7%	266.7%	7.4%	11.6%

Koment: Krahasimi i TM3 2023/2024, është vërejtur se numri i ankesave komerciale për të gjitha NJOU-të, është në rënie në krahasim me vitin 2023, ndërsa kërkesat teknike dhe komerciale në periudhën e njëjte të vitit 2024 janë në rritje si rezultat i një qasjeje të përmirësuar në leximin e ujëmatësve dhe

inspektimeve në teren ku konsumatorit i faturohet shpenzimi ndërsa në anë tjetër konsumatori deponojnë ankesën si një mjet për të larguar borxhin e shpenzuar. Po ashtu, shpërndarja e vërejtjeve përmes postës është një mjet i përdorur për të njoftuar konsumatorët në lidhje me detyrimet e tyre financiare, ka ndikuar në rritjen e rasteve të pranuar.

3.6 Inspektimi dhe Shkyçja


Tabela nr.34 Inspektimi dhe shkyçja TM3-2024

Nr	Përshkrimi	Korrik	Gusht	Shtator	TM3
1	Inspektime	858	1.060	749	2.667
2	Vizita për borgje	3.815	3.622	3.698	11.135
3	Shkyçjet për borgje	123	100	107	330
4	Ri kyçje pas pageses së borgjeve	91	56	72	219
5	Kyçje ilegale	47	43	34	124
6	Raste të dërguara ne gjykate	9	5	4	18
7	Nr. I pagesave nga konsumatorët	1.594	1.578	1599	4.771
8	Totali I pagesave pas inspekti.	263.232	300.828	285.240	849.300

Tabela nr.35 Inspektimi dhe shkyçja TM3-2023/2024

Nr.	Përshkrimi	TM3-2023	TM3-2024	Dallimi 2024/2023	Dallimi- %
1	Inspektime	2.222	2.667	445	20,03%
2	Vizita për borgje	8.475	11.135	2.660	31,39%
3	Shkyçjet për borgje	231	330	99	42,86%
4	Rikyçje të rregullta	156	219	63	40,38%
5	Kyçje ilegale	237	124	-113	-47,68%
6	Raste të dërguara në gjykatë	26	18	-8	-30,77%
7	Nr. i pagesave nga kons.	2.391	4.771	2.380	99,54%
8	Totali I pagesave pas inspektimeve	540.556	849.300	308.744	57,12%

Diagrami nr. 26.- Inspektimet-TM3-2024



Koment: Tabela nr. 35 paraqet të dhëna mbi inspektimet dhe shkyçjet për TM3-2023/2024. Inspektimet janë shtuar me 445 raste, duke arritur 2,667 inspektime, ndërsa vizitat për borxhe janë rritur me 2,660, duke arritur në 11,135. Kjo rritje vjen si rezultat i shtimit të inspektorëve dhe formimit të ekipeve në terren.

Shkyçjet për borxhe u rritën në 330, një rritje prej 99 krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa rikyçjet pas pagesave arritën në 219, një rritje prej 63. Diferenca mes shkyçjeve dhe rikyçjeve tregon se shumë konsumatorë kanë bërë pagesa ose marrëveshje për ri programim, veçanërisht për borxhe të mëdha. Pagesat janë dyfishuar nga 2,391 në 4,771, duke arritur inkasim prej 849,300 €, me një rritje prej 308,744 € krahasuar me TM2-2023, për shkak të inspektimeve dhe paralajmërimeve për borxhe.

Ka pasur një rënie prej 113 rastesh në kyçjet ilegale, kryesisht për shkak të rritjes së inspektimeve dhe vetëdijësimit të konsumatorëve. Shembull: në një lagje, faturimi dhe kallëzimi penal për një borxh në shumë të lartë u pagua menjëherë, duke sjellë edhe legalizime të reja. Ne përgjithësi, të dhënat tregojnë progres në menaxhimin e borxheve dhe inspektimeve, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave dhe efikasitetin në mbledhjen e borxheve të papaguara.

Tabela nr.36 Aktivitet për identifikimin, shkyçje, legalizim dhe arkëtim të borxheve sipas planit të biznesit 2024

Nr.	Përshkrimi	Të planifikuar a sipas PB	TM3-2024	Dallimi	Dallimi në %
1	Inspektime	2,300	2,667	367	14%
2	Vizita për borgje	8,540	11,135	2,595	23%
3	Shkyçjet për borgje	80	330	250	76%
4	Rikyçje të rregullta	45	219	174	79%
5	Kyçje ilegale	90	124	34	27%
6	Raste të dërguara te përmbaruesi	870	1,001	131	13%
7	Nr. I pagesave nga konsumatorët	2,500	4,771	2,271	48%
8	Totali I pagesave pas inspektimeve	550,550	849,300	298,750	35%

Koment: Tabela paraqet performancën e aktiviteteve kryesore për identifikimin, shkyçjen, legalizimin dhe arkëtimin e borxheve për periudhën TM3-2024 në krahasim me planin e biznesit për këtë periudhë. Shifrat tregojnë përparime të dukshme në shumicën e treguesve, duke reflektuar një rritje të ndjeshme në përpjekjet për përmirësimin e menaxhimit të borxheve dhe ndërhyrjeve në terren.


Për mbledhjen e mjeteve, edhe gjatë kësaj periudhe TM3 janë ndjekur procedura të intensifikuara, duke përfshirë dërgimin e rasteve të konsumatorëve me borxhe në Zyrën Ligjore për procesim të mëtejshëm nga përmbaruesi. Gjithashtu, qendra e thirrjeve ka realizuar kontakte me konsumatorët në borxhe, ndërsa inspektorët kanë kryer vizita për mbledhjen e borxheve të vjetra si dhe inspektimin e lidhjeve ilegale. Vërejtjet janë shpërndarë përmes Postës për të rikujtuar konsumatorëve pagesat e borxheve të vjetra.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, shumë konsumatorë kanë reflektuar në përputhje me kërkesat, duke paguar borxhin apo duke ri-programuar borxhet e tyre në vlerë prej **479,231.39 €** gjatë kësaj periudhe raportuese. Këto borxhe të ri-programuara pritet të arkëtohen sipas afateve të përcaktuara në kontratat e ri-programuara, duke kontribuar në rritjen e arkëtimeve dhe në përmbushjen e objektivave financiare të periudhës raportuese.

Tabela nr.37 Konsumatorë me dhe pa ujë matës TM3 2024

Nr	TM-2023/2024	Numri I konsumatorëve total	Konsumator me ujëmatës	Konsumator pa ujëmatës
1	TM3-2023	177.059	176.582	477
2	TM3-2024	179.165	178.693	472
3	Dallimi	2.106	2.111	-5
4	Dallimi- %	1,19%	1,20%	-1,05%

Diagrami nr.27 Konsumatorët pa ujëmatës -TM3-2023/2024



Koment: Sipas të dhënave nga programi, shumica e konsumatorëve (178,689) janë të pajisur me ujëmatës, ndërsa vetëm 472 janë pa të tillë. Megjithatë, është e domosdoshme dhe një obligim për të pajisur me ujëmatës një numër të madh konsumatorësh dhe për të zëvendësuar ujëmatësat ekzistues sipas vjetërsisë dhe mosfunksionimit. Për shkak të kostove të larta dhe sfidave financiare, nuk është e realizueshme zëvendësimi i të gjithë ujëmatësve që kanë nevojë. Për konsumatorët pa ujëmatës, për arsye teknike nuk është arritur ende pajisja e plotë, dhe inspektorët vazhdojnë të monitorojnë që të gjithë konsumatorët të jenë të pajisur me ujëmatës.

3.7 Aktivitetet kryesore

Drejtoria Komerciale përmbush të gjitha kompetencat dhe autorizimet në të gjithë zonën e shërbimit përmes Departamentit Komercial, Departamentit për Marrëdhënie me Konsumatorë, Departamentit të Kontrollës dhe Lidhjes, si dhe të gjitha NJOU-të.

Gjatë kësaj periudhe, përveç aktiviteteve të zakonshme, në vazhdimësi janë realizuar këto aktivitete kryesore:

- Organizimi i komunikimeve dhe takimeve me të gjitha NJOU-të për koordinimin e aktiviteteve të shërbimit për realizimin e objektivave.
- Janë **kontaktuar 2,419** konsumatorë për të pagesën e faturave.
- Janë zhvilluar takime me institucione për arkëtimin e borxheve, duke përfshirë barazimin e faturave për borxhet e vjetra.
- Shpërndarja e mbi **17,675 vërejtjeve** për konsumatorët përmes postës, duke përfshirë paralajmërimet për shkyçje dhe ftesat formale për pagesë.
- Përgatitja e listave për shkyçjen e konsumatorëve me borxhe të papaguara.
- Departamenti i Lidhjes dhe Kontrollës ka vazhduar aksionet për inspektim, zbulimin e kyçjeve ilegale, parandalimin e keqpërdorimeve të ujit dhe mbledhjen e borxheve.
- Qendra e Thirrjeve ka pranuar **8,066** raste të konsumatorëve për informacione teknike dhe komerciale dhe ka **kontaktuar 4,907** konsumatorë për pagesën e borxheve dhe nënshkrimin e kontratave të shërbimeve.
- Kontroll e vazhdueshme e lexuesëve në teren për verifikimin e leximit dhe shpërndarjen e faturave
- Zhvillimi i shërbimeve përmes aplikacionit mobil për të ofruar dëshmi me foto-komente se është duke u kryer shërbimi ndaj konsumatorit si duhet

3.8 Problemet e evidentuara

Gjatë periudhës Korrik - Shtator (TM3), janë evidentuar disa probleme që kanë penguar arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit. Problemet kryesore janë:

- Vazhdimi i faturimit me tarifa fikse për konsumatorët, për shkak të mungesës së ujëmatësve. Ndërrimi i plotë i ujëmatësve pritet të realizohet pas përfundimit të projektit për furnizim dhe montim.
- Vështirësi në leximin e ujëmatësve në terrenet e NJOU-ve, duke shkaktuar lexime të parregullta në disa zona.
- Mungesa e lexuesve të ujëmatësve dhe mbulimi i pamjaftueshëm i terrenit, veçanërisht në zonat e reja ku numri i konsumatorëve është në rritje.
- Pengesa në leximin e matësve në objekte pa qasje, si në ato me dyer të mbyllura të podrumeve në banesat kolektive.
- Rritje e numrit të ankesave dhe kërkesave nga konsumatorët, me një numër të madh për shqyrtim.
- Inspektimi i lexuesve ka zbuluar parregullsi në faturim, përfshirë mbi-faturimin, nën-faturimin dhe konsumatorë që nuk kanë marrë fatura.
- Probleme teknike me programin Mobile Offline për leximin e matësve.
- Aprovimi i ankesave nga ARRU dhe kërkesat për fshirje të borxhit për shkak të mos leximit të rregullt, sipas rregullores. Po ashtu, janë hasur sfida me borxhet e vjetra të aprovuara për parashkrim nga ARRU dhe gjykatat, bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD), që vazhdon të jetë një çështje e rëndësishme etj.

3.9 Masat e propozuara

Drejtoria Komerciale ka analizuar performancën gjatë kësaj periudhe dhe ka identifikuar disa pengesa në arritjen e objektivave. Për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar performancën, janë planifikuar masat e mëposhtme:

- Vazhdimi i kontrolleve dhe inspektimeve në terren për lexuesit, për të siguruar që faturimi bazuar në leximin e matësve reflekton konsumimin faktik.
- Filtrimi i konsumatorëve debitorë dhe dërgimi i listave në zyrën ligjore për procedim të rasteve tek përmbaruesi, si dhe për çështjet e lidhjeve ilegale.
- Eliminimi i gabimeve në faturim, përfshirë kontrollin e lexuesve
- Mirëmbajtja e vazhdueshme të programit Mobile Offline nga IT-ja dhe kompania kontraktuese për funksionim të qëndrueshëm.
- Përditësimi i bazës së të dhënave, përmirësimi i adresave dhe saktësimi i të dhënave të konsumatorëve
- Takime të rregullta me NJOU-të për të adresuar dhe eliminuar pengesat operative që ndikojnë në përmbushjen e objektivave.
- Takime me konsumatorët debitorë, veçanërisht me institucionet shtetërore, për të arritur marrëveshje mbi pagesën e faturave dhe nënshkrimin e kontratave të shërbimit.
- Filtrimi i konsumatorëve debitorë dhe kontaktimi nga Qendra e Thirrjeve, për t'i ftuar për pagesë.
- Analizë për konsumatorët që kanë vonesa në pagesa gjatë 12 muajve të fundit, me qëllim parandalimin e parashkrimit të borxheve.
- Dërgimi i vërejtjeve përmes postës për konsumatorët me borxhe të papaguara, për të nxitur pagesat e faturave.

IV. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

4.2 Aktivitetet kryesore

Në përputhje me obligimet rrjedhëse janë bërë të gjitha veprimet e domosdoshme operative lidhur me trajtimin e çdo dokumenti financiar.

Departamenti është kujdesur për çështjet si në vijim:

- Pagesa e shpenzimeve rrjedhëse
- Kontabilizimi i të gjitha shpenzimeve të operimit dhe investimeve
- Regjistrimi analitik i aseteve
- Komunikimi i vazhdueshëm me auditorët e NJAB gjatë nënshtrimit të proceseve audituese
- Mirëmbajtja e regjistrimeve, pranimi dhe dorëzimi i stoqeve përmes depos.
- Shkarkimi i pagesave të konsumatorëve të paguara nga kanalet online
- Operacionet ditore nëpër arkat
- Pagesa e TVSH- së dhe tatimeve tjera

Përgatitja e Pasqyrave vjetore financiare dhe raporteve mujore te ndryshme.

4.3 Shpenzimet – TM3-2024

Tabela nr.38 Realizimi i caqeve - Shpenzimet operative – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2023	TM3- 2024	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	1.970.766	2.167.043	196.277	9,96%
2	Fushë Kosovë	132.948	207.909	74.961	56,38%
3	Obiliq	194.816	82.502	-112.314	-57,65%
4	Graçanicë	75.749	53.639	-22.110	-29,19%
5	Shtime	48.427	93.533	45.106	93,14%
6	Lipjan	87.721	221.449	133.728	152,45%
7	Podujevë	219.481	134.885	-84.596	-38,54%
8	Drenas	197.021	189.018	-8.003	-4,06%
9	Gjithsej- KRUP	2.926.929	3.149.978	223.049	7,62%

Grafikoni nr.27- Realizimi i caqeve - Shpenzimet operative – TM3-2023/2024




Tabela nr.39 Realizimi i caqeve - Shpenzimet operative – TM3-2024

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Shpenzimet e blerjes së ujit me shumicë	231.377	228.806	2.571	1,12%	-98,88%
